

UDHEZIM

Nr. 2, date 17. 2.2004

PER DISA NDRYSHIME NE UDHEZIMIN NR.15, DATE 16.7.2003 "PER PROCEDURAT E HAPJES DHE MBYLLJES SE SALLAVE TE LOJERAVE ARITMETIKE, ELEKTRONIKE DHE PIKAVE TE LOJERAVE TE FATIT SPORTIVE"

Ne mbështetje te nenit 102/4 te Kushtetutës se Republikës te Shqipërisë, ligjit nr.8701, date 1.12.2000 "Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet" dhe ne zbatim te nenit 1 pika 2 te vendimit nr.238, date 13.4.2001 te Këshillit te Ministrave "Për kriteret e dhënies se lejes për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet" Ministri i Financave

UDHEZON:

1. Ne piken 1 germa "a" te udhëzimit nr.15, date 16.7.2003 fjala "kërkesë" zëvendësohet me fjalën "njoftim".
2. Ne piken 2 germa "a" te udhëzimit nr.15, date 16.7.2003 fjala "kërkesë" zëvendësohet me fjalën "njoftim".
3. Ne piken 3 germa "a" te udhëzimit nr.15, date 16.7.2003 fjala "kërkesë" zëvendësohet me fjalën "njoftim".
4. Pika 5 e udhëzimit nr.15, date 16.7.2003 ndryshon si me poshtë:
"Vetëm për shoqëri te licencuara ne lojëra fati, për transferimin e automateve te certifikuar dhe te miratuar, ne rastet e shtimit ose heqjen e automateve te rinj ne sallat ekzistuese, detyrohen te njoftojnë Drejtorinë e Lojërave te Fatit, Kazinove dhe Hipodromeve pranë Ministrisë se Financave." .
5. Pika 6 e udhëzimit nr.15, date 16.7.2003 ndryshon si me poshtë:
"Shoqëritë e lojërave te fatit detyrohen te njoftojnë me te njëjtën shkrese Drejtorinë e Lojërave te Fatit, Kazinove dhe Hipodromeve, Drejtorinë e Përgjithshme te Tatimeve, degën e tatim-taksave te rrethit përkatës, 15 dite përpara hapjes se sallave, pikave te basteve sportive, për transferimin, shtimin dhe heqjen e automateve elektronike.".
6. Pika 7 e udhëzimit nr.15, date 16.7.2003 ndryshon si me poshtë:
Verifikimi i hapjes se sallave, pikave te basteve sportive, si dhe transferimi, shtimi ose heqja e automateve elektronike kryhet nga ana e Policisë Tatimore. Akti i verifikimit do te dërgohet ne Drejtorinë e Lojërave te Fatit, Kazinove dhe Hipodromeve brenda 15 ditëve nga data e deklarimit te tyre.
"Ne rast se shoqëritë e lojërave te fatit nuk paraqesin dokumentacionin e parashikuar ne pikat 1, 2 dhe 3 te udhëzimit, nuk mund te ushtrojnë veprimtarinë pa e plotësuar këtë dokumentacion sipas kërkesave te këtij udhëzimi".

Ky udhëzim hyn ne fuqi me botimin e tij ne Fletoren Zyrtare.

MINISTERI I FINANCAVE

Arben Malaj